



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS  
Gjuhë C (1) (Anglisht)

**Ngarkesa:** 4 kredite, 60 orë

**Viti / Semestri :** Viti I, semestri I

**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme

**Programi i studimit:** Master i Shkencave, ‘‘Mësuesi në Gjuhë Angleze’’

**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

**Objektivat e përgjithshëm lëndore:** Të zhvillojë kompetencat komunikuese të nxënësve në gjuhën angleze, nëpërmjet metodave bashkëkohore të mësimdhënies si CLT dhe TBL. Të nxisë përdorimin funksional të gjuhës në kontekste reale dhe të përditshme, duke përfshirë të katër aftësitë bazë: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Të mbështesë zhvillimin e të nxënësve të pavarur dhe të personalizuar përmes përdorimit të burimeve shtesë dhe mbështetjes së vazhdueshme pedagogjike.

**Objektivat specifike lëndore:**

1. Të aftësojë nxënësit të shprehën në mënyrë të qartë dhe të natyrshme për tema të jetës së përditshme, duke përdorur struktura gramatikore të thjeshta dhe fjalor të përshtatshëm.
2. Të mësojë studentëve të analizojnë dhe përpunojnë informacionin e marrë nga tekste të lexuara dhe dëgjuara, si dhe ta përdorin atë në prodhim verbal dhe me shkrim.
3. Të orientojë nxënësit të aplikojnë gjuhën në kontekste të ndryshme praktike (shkrime formale dhe joformale, mesazhe, histori, etj.), duke rritur shkallën e vetëbesimit dhe ndërveprimit në gjuhë të huaj.

**Rezultatet e pritshme:**

1. Nxënësit do të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të reagojnë në mënyrë adekuate në biseda të zakonshme në anglisht, si dhe të diskutojnë mbi temat e trajtuara në tekst dhe përtej tij.
2. Do të demonstrojnë aftësi për të shkruar me saktësi gjuhësore në forma të ndryshme të shkrimit (mesazhe, letra, histori), duke përdorur fjalor të përvetësuar gjatë kursit.
3. Do të kenë përvetësuar teknika për të lexuar, kuptuar dhe përpunuar tekste në gjuhën angleze dhe për të zhvilluar më tej të nxënësve në mënyrë të pavarur.